

## **URDHËR**

**Nr. 61. Dat ë, 08.02.2006**

### **PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË TURQI**

Mbështetur në Ligjin “ Për Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar” Nr. 9038 datë 4.11.2004.

Mbështetur në njoftimin e marrë nga Organizata Botërore e Shëndetit të kafshëve (OIE) për shfaqjen e sëmundjes së Aftës Epizootike në Turqi.

Mbështetur në Kodin Ndërkombëtar të Shëndetit të Kafshëve.

### **URDHËROJ :**

1. Ndalohet importimi i kafshëve të gjalla të llojeve: gjedhë, derra, bagëti të imta nga territori i Turqisë për në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Ndalohet importimi i mishit dhe qumështit të papërpunuar nga territori i Turqisë për në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Produktet e mishit dhe qumështit të përpunuara lejohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë kur plotësojnë kushtet si më poshtë:
  - Të jenë me origjinë nga zona të pa prekura nga sëmundja e Aftës Epizootike,
  - Të jenë të përpunuara në fabrika të lejuara për eksport,
  - Të jenë të përpunuara në kushte teknologjike që shkatërrojnë virusin e Aftës Epizootike.
    1. Certifikata Veterinare e Turqisë të garantojë origjinën e tyre dhe të konfirmojë kushtet e pikës 3 të këtij urdhëri.
    2. Ndalohet importimi i ushqimeve për blektorinë që kanë në përbërjen e tyre produkte me origjinë shtazore,
    3. Ndalohet importimi i materialeve biologjike nga territori i Turqisë për në territorin e Republikës së Shqipërisë.
    4. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë , Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Inspektoriati Veterinar në Pikat e Inspektimit Veterinar Kufitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Jemin Gjana**